

DREJTORIA E AUDITIT TË BRENDSHËM

Nr. 203 prot

Tiranë, më 15 / 1 2016

**Lënda:** Raporti i Veprimtarisë së Njesisë së Auditimit të Brëndshëm për vitin 2015.

**Drejtuar:** Ministrisë së Financave

Njesisë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm

**TIRANË**

Në zbatim të pikës ç, të nenit 14, të Ligjit Nr.114, datë 22.10.2015, "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", procedurave të përcaktuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe në zbatim të Kapitullit V, të Udhëzimit nr.12, datë 05.06.2012, "Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në Sektorin Publik", po ju dërgojmë zyrtarisht "Raportin e Veprimtarisë të Njesisë së Auditimit të Brëndshëm për vitin 2015", me evidencat e miratuara.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

\_\_\_\_\_  
**Elira KOKONA**

Kon. Aida Toqi

Mir. Edmonda Shkjezi



**RAPORT**  
**MBI VEPRIMTARINË E DREJTORISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË**  
**MINISTRINË E KULTURËS PËR VITIN 2015**

**I.HYRJE**

Në zbatim të Ligji nr.9720, datë 23.04.2007, “Për auditimin e brendshëm ne sektorin publik”, I ndryshuar shfuqizuar me Ligjin nr.114, datë 22.10.2005, “Për auditin e brendshëm në sektorin publik “, Drejtoria e Auditimit te Brendshëm (DAB) në MK ka përgatitur raportin vjetor të veprimtarisë së auditimit të brendshëm për vitin 2015.

**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm (DAB) në MK është drejtori e cila funksionon në mbështetje të Ligjit “Për auditimin e brendshëm ne sektorin publik” me varësi funksionale nga Titullari i Ministrisë, ka funksionuar sipas strukturës së miratuar nga Kryeministri me Urdhrin nr.99, datë 29.06.2015, i ndryshuar. Numri total i punonjësve të saj është 5 (pesë). Punonjësit në DAB janë të pajisur me certifikatën e auditimit si dhe kanë përmbushur detyrimin për kryerjen e 40 orëve trajnim te përditësuar në fushën e auditimit sipas planifikimit të NJQH/AB

Në Planin Vjetor dhe Strategjik 2015-2019 janë planifikuar të kryhen për vitin 2015, 27 auditime, janë realizuar 29 në masëm 107%. Nga Auditimet e realizuaraë kanë përfunduar 23 auditime, 5 auditime të përfunduara por të pa evaduara dhe 1 auditim në proces.

Gjetjet kryesore të konstatuara nga kjo veprimtari lidhen kryesisht me ;

- Mosfunksionim siç duhet të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, në fushën e pagesave;
- Mbipagesa për shpërblime të pa autorizuara.
- Shkelje dhe parregullsi të tjera të evidentuara si pasojë e menaxhimit të dobët të burimeve/asete publike.
- Mungesa e kapaciteteve të burimeve njerëzore.

Probleme janë hasur gjithashtu në fushën e zbatimit të akteve ligjore dhe proceduriale, deri në moszbatim apo keqinterpretim të VKM-ve apo ligjeve.

Gjetjet në fushën e menaxhimit financiar dhe fushave specifike konstatuar nga DAB, për vitin 2015 rezultojnë në vlerën 1,046 mijë lekë, të cilat janë kërkuar për zhdëmtim 9 personave.

Në dy raste është lënë në kompetencë të titullarëve për të analizuar përgjegjësitë dhe vendosur për ecuri disiplinore.

Natyra e rekomandimeve i referohet gjetjeve të auditimit, për evidentimin, rregullimin dhe përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, parandalimin e shpërdorimeve dhe shkeljeve, ruajtjen e aseteve publike si dhe zhdëmtimin e vlerave të shkaktuar nga personat përgjegjës ose të përfituara padrejtësisht gjithashtu dhe përmirësime të kuadrit ligjor.

Nga shqyrtimi i sigurimit të cilësisë të praktikave të auditimit, rezulton se përgjithësisht ato janë konformë standarteve dhe praktikave profesionale të auditimit por duhet pranuar në drejtim të përmirësimit të cilësisë dhe të zbatimit të standarteve të auditimit, gjithnjë ka vend për më tepër përmirësim, duke patur parasysh se këto kërkesa nuk mbeten statike.

## **II Baza ligjore.**

Në ushtrimin e veprimtarisë së saj, Drejtorja e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Kulturës është përbajtur parimeve të përgjithshme të funksionimit të auditimit të brendshëm, drejtimeve kryesore dhe objektit të tij, të percaktuara këto në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

- Ligji nr.9720, datë 23.04.2007, “Për auditimin e brendshëm ne sektorin publik”, ndryshuar me ligjin nr.10318, datë 16.09.2010, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9720, date 23.4.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i shfuqizuar si dhe të Ligjit nr.114, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm ne sektorin publik”,
  - VKM nr.212, dt 30.03.2012, “Per miratimin e kriterëve për ngritjen e njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, e shfuqizuar .
  - Manualin e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik, miratuar me Urdhërin nr 69, datë 29.09.2010 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”.
  - Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.12, dt 05.06.2012, “Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”.
  - Rregulloren e brendëshme të organizimit dhe funksionimit të DAB.
- Krahas kuadrit të mësipërm, baza ligjore e rregullatore për auditimin e brendshëm plotësohet me paketën profesionale ndërkombëtare që përfshin Kuadrin e Praktikave Profesionale Ndërkombëtare, i cili përmban Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm dhe Praktikën Profesionale të publikuara nga IIA ( Instituti i Auditimit të Brendshëm )
- Në ushtrimin e veprimtarisë së saj DAB në MK, i është përbajtur dhe i përmbahet parimeve, drejtimeve dhe objektit të auditimit të brendshëm të percaktuara në nenin 4,5 e 7 të Ligjit nr.9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, ndryshuar.

## **III. Organizimi**

### **Misioni i auditimit të brendshëm.**

Veprimtaria e auditimit të brendshëm si veprimtari e pavarur mbështet menaxhimin e subjekteve publike për arritjen e objektivave të tyre, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim për të shtuar vlerën, duke nxitur ndryshime që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë.

### **Objektivat kryesore të DAB.**

Në funksion të përmbushjes së misionit të saj, objektivat kryesore të veprimtarisë audituese janë

- ✓ vlerësimin i sistemeve të kontrollit të brendshëm, manaxhimit të riskut dhe proceseve të qeverisjes;
- ✓ dhënia e sigurisë së arsyeshme nëse:

-informacionet e rëndësishme financiare, të drejtimit dhe operacionale janë të sakta, të besueshme dhe në kohën e duhur;

-burimet janë përdorur me kursim, dobi dhe frytshmëri;

-asetet janë ruajtur;

-veprimtaritë e subjekteve janë në pajtueshmeri me politikat, procedurat, ligjet dhe rregulloret e miratuara;

-objektivat kryesore të percaktuara në programet dhe planet e subjekteve janë arritur.

✓ dhënia e rekomandimeve dhe të kërkesave për marrjen e masave për përmirësimin e veprimtarisë.

### **Organizimi, përbërja dhe funksionimi i strukturës së auditimit.**

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm (DAB) në MK është drejtori e cila funksionon në mbështetje të Ligjit nr.9720, datë 23.04.2007, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar dhe shfuqizuar me Ligjin nr.114, datë 22.10.2015, "Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", ka funksionuar sipas strukturës së miratuar nga Kryeministri me Urdhrin nr.99, datë 29.06.2015, "Për disa ndryshime në Urdhërin nr.185, datë 18.10.2013, "Për miratimin e strukturës dhe organikës në Ministrinë e Kulturës". Numri total i punonjësve të saj është 5 (pesë).

Drejtoria është e organizuar në Drejtori më vete me varësi funksionale nga Titullari i Ministrisë ndërsa varësia administrative (lidhur edhe me statusin e nëpunësit civil, etj) është nga Sekretari i Përgjithshëm.

### ***IV.Rezultatet e Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm***

#### ***Analiza e programeve të auditimit për periudhën raportuese.***

Që në fazën e planifikimit, në programimin e subjekteve dhe të tematikave të auditimit, **jemi mbështetur në këto kritere :**

- ✓ Përfshirjes në Planin Vjetor të Auditimeve të Vitit 2015, të subjekteve të cilët mbartin risk të lartë.
- ✓ Të hartimit të planeve mbi bazë risku, duke u orjentuar në identifikimin dhe përfshirjes për auditim të fushave me risk, duke përcaktuar prioritetet e auditimit të brendshëm në pajtueshmeri me qëllimin e njësisë shpenzuese/subjektit për auditim;
- ✓ Duke marrë në konsideratë informacionet nga menaxhimi i lartë;
- ✓ Në përcaktimin e prioriteteve dhe mjeteve për të arritur objektivat me një kosto sa më efektive;
- ✓ Në rëndësinë e subjekteve dhe të drejtimeve të auditimit,
- ✓ Në përcaktimin e afatit të auditimit prej jo më pak se një herë në dy vjet.
- ✓ Në rezultatet përfundimtare të auditimit të mëparshëm, rekomandimet e dërguara.

#### **Metodologjia e auditimit.**

Gjatë vitit 2015, një drejtim mjaft i rëndësishëm i veprimtarisë së DAB, ka qenë vlerësimi dhe zbatimi i standarteve të auditimit.

Proceset e auditimit të realizuara nga DAB, janë karakterizuar me :

- Njohjen paraprake të natyres së subjektit që auditohet,
- Përcaktimin e drejtimeve dhe çështjeve që do të mbulojë auditimi,

- Vleresimin e riskut të mjedisit të përgjithshëm të kontrollit, vleresimin e riskut për fushat dhe sistemet dhe materialiteti
- Transparencën dhe metodën e ballafaqimit me personat përgjegjës.
- Objektiviteti dhe paanësia në vleresim,
- Përgatitjen e dokumentacionit të auditimit dhe masave rekomanduese.


Në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007, “Për Auditin e Brendshëm në Sektorin Publik” të shfuqizaur me ligjin nr.144, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brëndshëm në sektorin publik” si dhe të Manualit të Auditimit të Brendshëm, llojet e auditimit të brëndshëm kanë qenë kryesisht auditimet me bazë sistemi, auditime të performancës dhe auditime mbi zbatimin e rekomandimeve.

Sipas Programit Vjetor të Auditimit të Brendshëm të miratuar nga Ministri i Kulturës me nr.4703, datë 15.10.2014 “Plani vjetor dhe strategjik 2015-2019” janë planifikuar të kryhen për vitin 2015, gjithsej 27 auditime.

Numri i misioneve të programuara dhe të realizuara sipas natyrës së tyre, po e paraqesim në tabelën nr. 1, dhe grafikisht si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Të planifikuara	Të realizuara	Realizimi në %
1	Auditime të pota	14	14	100%
2	Auditime të pjesëshme	13	15	115%
	<b>Shuma</b>	<b>27</b>	<b>29</b>	<b>107%</b>

**Grafiku 1.**



Plani Vjetor për auditimet e plotë është realizuar 100%, ka vetëm një shmangie, subjekti i planifikuar për auditim konkretisht Alba Film Studio Sh.A është audituar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, me kërkesë të titullarit u programua në vitin 2015 për tu audituar Parku Kombëtar i Butrintit i planifikuar për tu audituar në vitin 2016.

Auditimet e pjesëshme janë realizuar në masën 115%, tejkalimi përfajson katër auditime shtesë me objekt zbatimin e rekomandimeve, ka patur shmangie në 6-mujorin nga 6 auditime të planifikuara janë realizuar katër të përputhshmërisë.


-Angazhimin, ndjekjen dhe zbatimin i tematikave të iniciuara nga Titullari për verifikimin e problematikave, për të cilat kërkohej auditim.

-Shfaqja dhe bërja prezent e Riskut për fusha të veçanta gjatë ushtrimit të veprimtarisë së subjekteve.

Për 6-mujorin e II, të vitit 2015 sipas planit janë planifikuar 13 misione auditimi dhe janë realizuar 17 misione auditimi, realizuar në masën 131%.

Raportimi mbi ecurinë e angazhimeve për vitin 2015 është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Nr	Të përfunduara dhe të evaduara	Të përfunduara por të pa evaduara	Në proces të punës në terren
1	23	5	1



Në përgjithësi kjo shpërndarje përfaqëson një angazhim të arësyeshem të burimeve dhe tregon se angazhim kryesor mbeten auditimet e plota dhe më pas sipas nevojës së subjekteve të audituara, kryerja e auditimeve të pjesëshme dhe të tjera duke shmangur në maksimumin e mundshëm ndërhyrjet e paargumentuara në planet e auditimit.

### ***III. Fushat me risk më të lartë dhe trajtimi i tyre***

Në Planet Strategjike dhe Vjetore të DAB janë identifikuar dhe vlerësuar risqet kryesore për veprimtarinë e subjekte publike.

Përcaktimi i fushave me risk të lartë është bërë që në fazën e planifikimit të veprimtarisë për vitin 2015. Megjithatë, si rezultat i ndryshimit të planit vjetor është bërë dhe rivlerësimi i riskut gjatë vitit dhe kur menaxhimi e ka gjykuar të arsyeshme, për fusha të cilat risku në situata të vecanta paraqitet më i lartë se vlerësimi në Planin Vjetor, janë kryer misione auditimi me urdhër të veçantë të titullarit. Atje ku risku është vlerësuar i një niveli të lartë, vëmendje e madhe i është kushtuar procesit të ndjekjes së rekomandimeve duke synuar jo vetëm përcaktimin e dëmit të shkaktuar apo përgjegjësi, por mbi të gjitha përmirësimin dhe parandalimin e përsëritjes në të ardhmen.

### ***III. Gjetjet kryesore sipas sistemeve.***

Gjatë ushtrimit të funksionit të saj DAB, ka nxjerrë në pah hallkat më të dobëta dhe jo funksionale të sistemit, të cilat kanë sjellë dhe pasojat e tyre negative në përdorimin me dobi, kursim dhe frytshmëri të fondeve publike.

Gjetjet kryesore të konstatuara nga kjo veprimtari lidhen kryesisht me ;

Mosfunksionim siç duhet të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, në fushën e pagesave;

Mbipagesa për shpërblime të pa autorizuar

Shkelje dhe parregullsi të tjera të evidentuara si pasojë e menaxhimit të dobët të burimeve/asete publike

Probleme janë hasur gjithashtu në fushën e zbatimit të akteve ligjore dhe proceduriale, deri në moszbatim apo keqinterpretim të VKM-ve apo ligjeve.

Gjetjet në fushën e menaxhimit financiar dhe fushave specifike konstatuar nga DAB, për vitin 2015 rezulton në vlerën 1,046 mijë lekë.

Për kategorinë e gjetjeve të sipërpërmendura, vlerësohet se peshën kryesore e zënë gjetjet në ato subjekte të cilat në Planin Vjetor kanë qenë përcaktuar me risk të lartë dhe që lidhen kryesisht me zbatimin jo të drejtë të kuadrit ligjor.

Gjetjet kryesore të rezultuara nga kjo veprimtari lidhen kryesisht me:

- Në fushën e sistemit të pagesave në shumën 126 mijë lekë, kërkuar për zhdëmtim 1 person.
- Gjetjet në sistemin e pagesave me dëm ekonomik në shumën 200 mijë lekë, kërkuar për zhdëmtim 7 persona.
- Veprime në kundërshtim me ligjin për konfliktin e interesit me dëm ekonomik në shumën 720 mijë lekë, kërkuar për zhdëmtim 1 person.
- Në dy raste është lënë në kompetencë të titullarëve për të analizuar përgjegjësitë dhe vendosur për ecuri disiplinore.

Gjithashtu janë rekomanduar përmirësime të kuadrit ligjor.

Rekomandimet e dhëna bazuar në natyrën e gjetjeve janë për përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, ndreqjen e parregullsive, parandalimin e shpërdorimeve dhe shkeljeve, ruajtjen e aseteve publike, çdëmtimin e vlerave për dëme të shkaktuara nga persona përgjegjës ose të përfituara padrejtësisht, rivlerësime të detyrimeve tatimore për dyshime për shmangie tatimore ose evazion,

Natyra e rekomandimeve i referohet gjetjeve të auditimit, për evidentimin, rregullimin dhe përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, parandalimin e shpërdorimeve dhe shkeljeve, ruajtjen e aseteve publike si dhe zhdëmtimin e vlerave të shkaktuara nga personat përgjegjës ose të përfituara padrejtësisht.

## **V. Rekomandimet**

### ***Rekomandimet e propozuara***

Drejtoria e auditimit ka specifikuar si një nga prioritetet e saj ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, rritjen e cilësisë së tyre si dhe forcimin e bashkëpunimit me njësitë e audituara me qëllim që ato të shërbejnë për ndreqjen e parregullsive e gabimeve dhe përmirësimin e menaxhimit dhe sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Subjektet i janë përgjigjur pjesërisht auditimeve duke përcjellë Planin e Veprimit për rekomandimet.

Për vitin 2015 janë adresuar gjithësej 47 rekomandime, ***të ndara si vijon:***

- *Rekomandime organizative 43,*
- *Rekomandime me masë zhdëmtimi 4,*

Në 4 raste, janë rekomanduar masa zhdëmtimi dhe likuidimi për punonjësit e subjekteve të audituara, në shumën 1.046 mijë lekë

Rekomandimet organizative të lena në subjekte janë pranuar nga titullarët në masën 100% dhe janë realizuar në masën 60% ndërsa 19 rekomandimet në proces përbëjnë 40% të totalit të rekomandimeve, nga të cilat 7 rekomandime janë të auditimeve të përfunduara në muajin dhjetor . Bazuar në Ligjin “Për Auditin e Brendshëm në Sektorin Publik” zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga auditimi është ndjekur me prioritet, duke u përpjekur që verifikimi i tyre të kryhet brenda afateve nga adresimi i tyre. Duke rakorduar nevojat për auditimin e ndjekjes së rekomandimeve, për 6 mujorin e II të vitit 2015 janë zhvilluar 11 misione auditimi për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve që plotësojnë kriterin kohor. Auditimet për zbatimin e rekomandimeve kanë qenë fokusuar në:

- Sigurimin që sistemi i bashkëpunimit për ndjekjen e rekomandimeve të auditimit është i dokumentuar në mënyrën e duhur.
- Sigurimin se është kthyer përgjigje në kohën e duhur, si dhe janë ndërmarrë veprimet korrigjuese në zbatim të rekomandimeve.
- Zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve që lidhen me çështjet e auditimit.

Përgjithësisht njësitë e audituara kanë bashkëpunuar me grupet e auditimit për të diskutuar, pranuar dhe zbatuar rekomandime që janë të bazuara në gjetjet e auditimit si dhe ndihmojnë



subjektin publik në përmirësimin e punës, ndreqjen e parregullsive por edhe në evidentimin e përgjegjësive dhe shmangien e tyre për periudhën në vijim. Por jo në të gjitha rastet, kjo ka qenë në vëmendjen e duhur për një bashkëpunim eficient.

## **VI. Monitorimi i sistemit dhe sigurimit të cilësisë**

Rishikimi dhe vlerësimi i cilësisë për materialet e auditimit është realizuar nga Kryetari i grupit të auditimit ( proces i cili është realizuar gjatë procesit të auditimit )dhe nga Drejtori i Drejtorisë së Auditimit, konformë kërkesave dhe procedurave të percaktuara në :

- Pikën 4.8 “Sigurimi i cilesisë së punës“ të Manualit të Auditimit të Brendshëm.
- Pikën 3.3.5 të Udhëzimit nr.12, datë 05.06.2012, të Ministrisë së Financave “Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik“.

Nga shqyrtimi i sigurimit të cilësisë të praktikave të auditimit, rezulton se përgjithësisht ato janë konformë standarteve dhe praktikave profesionale të auditimit, më konkretisht :

- Jane dhene opinione profesionale te mbeshtetura ne gjykime objective.
- Raportet e auditimit janë pergatitur me kompetencë e profesionalizëm.

Megjithatë duhet pranuar në drejtim të përmirësimit të cilësisë dhe të zbatimit të standarteve të auditimit, gjithnjë ka vend për më tepër, duke patur parasysh se këto kërkesa nuk mbeten statike.

## **VII. Analiza Kapacitive audituese**

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm (DAB) në MK është drejtori e cila funksionon në mbështetje të Ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar. DAB ka funksionuar sipas strukturës së miratuar nga Kryeministri me urdhrin nr.185, datë 18.10.2013 “Për miratimin e strukturës dhe organikës në Ministrinë e Kulturës” ndryshur. Numri total i punonjësve të saj është 5 (pesë) si mëposhtë:

- 1 Drejtor Drejtorie
- 4 specialistë

Për vitin 2015 DAB ka funksionuar me 4 punonjës.

Drejtoria është e organizuar në Drejtori më vete me varësi funksionale nga Titullari i Ministrisë ndërsa varësia administrative (lidhur edhe me statusin e nëpunësit civil, etj) është nga Sekretari i Përgjithshëm.

Arsimi bazë për punonjësit e auditimit është profesioni ekonomist dhe të gjithë punonjësit janë të çertifikuar sipas kërkesave ligjore.

Kanë përmbushur detyrimin për kryerjen e 40 orëve trajnim te përditësuar në fushën e auditimit sipas njoftimeve të NJQH/AB dhe e kanë përfunduar me sukses vlerësimin e njohurive. Njohuritë e marra gjatë trajnimeve i ka vënë në zbatim dhe kanë patur ndikim të dobishëm në performancë.

## **VIII. Konkluzione**

**Per vitin 2015, gjate veprimtarisë së DAB, vecojmë këto aspekte :**

- Veprimtaria e DAB në M.Kulturës, si njësi e auditimit, ka varësi funksionale tek Ministri i cili është niveli më i lartë i menaxhimit në MK. Ky përcaktim varësie përputhet me kërkesat e dispozitave ligjore, të përcaktuara në pikën 1 të nenit 17, të ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, shfuqizuar me Ligjin nr.114, datë 22.10.2005, “Për auditin e brendshëm në sektorin publik”;
- Punonjësit e NjAB në MK, aktualisht kanë një kualifikim dhe përberje profesionale në përputhje me kërkesat e Ligjit “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar;
- Kjo strukturë është përqëndruar në vlerësimin dhe efikasitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në strukturat e varësisë, konforme kërkesave ligjore të përcaktuara në Ligjin “Për auditimin e brendshëm”.
- Plani i auditimeve është realizuar në masën 107%. Janë kryer 29 angazhime auditimi, nga të cilat 23 të evaduar, 5 në proces evadimi dhe 1 në terren.
- Vlerat e gjetjeve i takojnë parregullsive në fushën e menaxhimit të fondeve publike dhe vlera e dëmit ekonomik e konstatuar nga DAB, konsiston në **shumën 1.046 mijë lekë**.
- Janë dhënë 47 rekomandime gjithsej për përmirësimin e punës, ndreqjen e parregullsive për vitin 2015 dhe masa zhdëmtimi.
- Burimet e auditimit janë përdorur në përputhje me planifikimin. Nga 5 auditues të miratuar në organikë, për vitin 2015 janë 4 auditues të cilët janë të certifikuar, gjithashtu janë përfshirë dhe specialist të jashtëm sipas nevojave të DAB.
- Janë zbatuar detyrimet e përcaktuara në ligjin “Mbi auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Planin Vjetor të Auditimit 2015, dhe Planin Strategjik të Auditimit të Brendshëm 2015-2019.
- DAB ka ushtruar veprimtarinë e saj në përputhje me standardet, procedurat dhe etapat e auditimit të përcaktuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe Udhezimin në fuqi, në fushën e Auditimit të Brendshëm.
- Ka rritur efektivitetin e veprimtarisë së saj, nëpërmjet shfrytëzimit me të mirë dhe rritjes profesionale të stafit auditues.
- Ka rekomanduar marrjen e masave me karakter organizativ, administrativ e disiplinor si dhe sipas rasteve konkrete përmirësimin e akteve administrative si dhe ka kryer auditime për zbatimin e tyre nga drejtuesit e institucioneve të ndryshme.

### **Prioritetet për vitin e ardhshëm.**

- ❖ Përmirësimi i sistemit të programimit dhe metodologjisë së vlerësimit të riskut sipas sistemeve.
- ❖ Vlerësimi i ngritjes dhe funksionimit të Kontrollit të Brendshëm sipas sistemeve.
- ❖ Kualifikimi i vijueshëm i stafit, rritja e nivelit të njohjes dhe vlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm të aktiviteteve që përfshijn MK si dhe të institucioneve të tjera në varësi të saj.
- ❖ Zbatimi i standarteve të Auditimit, me qëllim rritjen e parametrave cilësor në punën audituese.
- ❖ Të punojë në vazhdimësi për rritjen e besueshmërisë, objektivitetit, pavarësisë dhe paanesisë në veprimtarinë e saj audituese.
- ❖ Mbatja në vazhdimësi e marrëdhënieve korrekte, të qëndrueshme dhe transparente me strukturat e NJQHAB në Ministrinë e Financave, Inspektimit Financiar në Ministrinë e Financave, KLSH, Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Linjës dhe subjektet e varësive, për të

krijuar një frymë bashkëpunimi e ndërveprimi reciprok në luftën kundër dukurive negative, në luftën e përbashkët kundër korrupsionit, krimit në ekonomi e më gjerë.

Ju faleminderit për bashkëpunimin,

**DREJTOR**

Edmonda SHKJEZI



## ANEKSI 25: PYETËSORI I VETËVLERËSIMIT PËR AUDITIMIN E BRENDSHËM

Njësia Publike:		Ministria Kultures				
Emri, Mbiemri i Drejtuesit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NjAB) dhe adresa e e-mail:		Edmonda Shkjezi, eshkjezi@yahoo.it				
Data e plotësimit (sipas protokollit):		15.01.2016				
Përshkrimi i pyetjeve të pyetësorit sipas ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi për auditimin e brendshëm.						
Jo	Kriteri	Rezultati				Arsyetimi i zgjedhjes 1, 2, 3, 4
		1	2	3	4	
<b>Kërkesat kyçe për AB</b>						
1	NjAB është ngritur në përputhje me kërkesat e ligjit për auditimin e brendshëm dhe aktet nënligjore.				+	DAB në MK është ngritur në zbatim të kërkesave të ligjit për auditimin e brendshëm në sektorin public dhe akteve nënligjore.
2	NjAB kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e ligjit për auditimin e brendshëm dhe Manualin e Auditit të Brendshëm (MAB).				+	Në zbatim dhe te manualist specifik.
3	Karta e Auditit të Brendshëm është hartuar dhe miratuar dhe plotëson kërkesat e MAB.				+	Karta e Auditit të Brendshëm është miratuar nga titullari i MK.
4	Aktet specifike për fusha të veçanta të auditimit të brendshëm janë zhvilluar dhe miratuar sipas ligjit.				+	Po
5	NjAB është e pavarur nga ana funksionale dhe raporton drejtpërdrejt tek Titullari i Njesisë Publike.				+	DAB është e organizuar në drejtori më vete dhe raporton tek Ministri.
6	Fusha e mbulimit të Auditimit të Brendshëm përfshin të gjitha aktivitetet e Njesisë Publike.				+	Po
<b>Totali i pikëve të seksionit "Kërkesat kyçe për auditimin e brendshëm"</b>					<b>24</b>	
<b>Struktura organizative e NjAB, punonjësit, kualifikimet dhe aftësitë profesionale të audituesve të brendshëm</b>						
7	Struktura e NjAB respekton kërkesat e minimumit ligjor (minimumi 1 Drejtues dhe 2 specialistë të auditimit të brendshëm).				+	DAB përbëhet nga 5 vetë, 1 drejtor 4 specialist
8	Audituesit e Brendshëm plotësojnë kriteret e punësimit				+	Të gjithë janë të pajisur me certifikatën "Auditues të brendshëm"
9	NjAB përmbush kërkesat vjetore për trajnimin e vijueshëm profesional.				+	Ndjekin rregullisht 40 orëshin e trajnimit të Vijueshëm.
10	Veprimtaria e audituesve të NjAB është në përputhje me Kodin e etikës së Audituesve të Brendshëm, të miratuar nga Ministri i Financave.				+	DAB I përmbahet me korrektësi Kodit të Etikës miratuar nga Ministri I MF dhe Kodit të Etikës DAB miratuar nga Ministri I Kulturës.
<b>Totali i pikëve të seksionit "Struktura organizative e NJAB, punonjësit, kualifikimet dhe aftësitë profesionale të audituesve të brendshëm"</b>					<b>16</b>	
<b>Planifikimi dhe raportimi i veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm</b>						

11	Planifikimi Strategjik dhe Vjetor i NjAB përmbush kërkesat dhe miratohet nga Drejtuesi i Njesisë Publike.				+	Planifikimi Strategjik dhe Vjetor i DAB është hartuar në zbatim të ligjit për Auditimin e Brendshëm dhe miratuar nga Ministri I
12	Procesi i hartimit dhe miratimit të planit Strategjik dhe Vjetor kryhet brënda afateve të përcaktuara.				+	Po, miratuar me shkresë nr.4703, datë 15.10.2014 "Plani vjetor dhe strategjik 2015-2019"
13	Objektivat e Planit Strategjik dhe Vjetor të NjAB janë të përcaktuara qartësisht dhe në përputhje me objektivat e Njesisë Publike.				+	Janë bazuar në risk dhe objektivat e MK.
14	Procesi i identifikimit dhe vlerësimit të riskut mbulon të gjithë fushat e auditimit.				+	Audituesit marrin në konsideratë si riskun e fushave, ashtu dhe rëndësinë e tij në subjekt.
15	Risqet që lidhen me objektivat e NjAB janë identifikuar dhe vlerësuar drejt.				+	po
16	Plani Strategjik dhe Vjetor pasqyron rezultatin e procesit të identifikimit dhe vlerësimit të riskut.				+	Po, duke ju referuar auditimeve të mëparshme dhe regjistrin te riskut .
17	Burimet e nevojshme përlogariten dhe shpërndahen në mbështetje të objektivave.				+	Po
18	Ndryshimet e bëra gjatë zbatimit të planit janë pjesë e dosjes së planit dhe argumentohen me shkrim.				+	Për cdo herë janë bërë pjesë e dosjes. Për vitin 2015 nuk ka patur ndryshime gjatë vitit.
	<b>Totali i pikëve të seksionit "Planifikimi dhe raportimi i veprimtarisë së auditimit të brendshëm"</b>				3	28
<b>Përmbushja e standardeve gjatë kryerjes së veprimtarisë audituese</b>						
19	Angazhimet e auditimit përmbushen sipas aktiviteteve të parashikuara në Planin Vjetor.				+	DAB I përmbahet planit vjetor, mund te kete devijime Vetëm në rastet kur kërohet nga Titullari I MK.
20	Programi i çdo angazhimi respekton formën dhe përmbajtjen sipas kërkesave të MAB.				+	Për cdo rast.
21	Programi miratohet nga Drejtuesi i NjAB.				+	Për cdo rast
22	Çdo angazhim auditimi kryhet sipas kërkesave të MAB.				+	DAB angazhimet e auditimit i kryen mbwshtetur në MAB
23	Formati standard për vlerësimin e kontrollit të brendshëm, nivelit të riskut dhe komponentëve të tjerë plotësohen dhe përmbajnë informacion cilësor.				+	Në përcaktimin e nivelit të riskut mund të ketë nevoj për përmirësim në të ardhmen
24	Përcaktimi i numrit dhe llojit të testeve dhe rezultatet e tyre janë të dokumentuara qartë dhe të përfshira në dosje.				+	Për cdo dosje auditimi.
25	Procedurat për përgatitjen dhe dërgimin e raportit tëauditimit zhvillohen në përputhje me kërkesat e MAB (fazat e raportimit).				+	DAB raporton në mënyrë periodike dhe vjetore duke Informuar mbi gjetjet dhe rekomandimet e auditimit.
24	Vërejtjet e subjektit të audituar janë pjesë e dosjes dhe raportit final.				+	Për cdo rast
26	Në çdo rast Plani i Veprimit i hartuar nga pala e audituar, diskutohet dhe miratohet nga Titullari i njesisë publike dhe i dërgohet për informacion NjAB-së				+	Për cdo rast kërkohet të miratohet dhe bëhet pjesë e dosjes.
27	Çdo rekomandim i pasqyruar në raport është i lidhur me gjetjet.				+	Për cdo rast.

28	Zbatimi i rekomandimeve monitorohet.				+	Për periudhë 6-mujore dhe vjetore sipas nivelit të rëndësisë.
	<b>Totali i pikëve të seksionit "Përmbushja e standarteve gjatë kryerjes së veprimtarisë audituese"</b>		3		36	
<b>Rishikim i brendshëm i cilësisë së veprimtarisë audituese</b>						
29	Rishikimi i brendshëm i cilësisë përfshin të gjitha fazat e auditimit (planifikimin, punën në subjekt dhe raportimin) dhe dokumentohet.				+	Po
30	Rishikimi i brendshëm i cilësisë kryhet nga Drejtuesi i NjAB-së ose nga një person i autorizuar prej tij/saj.				+	Rishikimi i brendshëm i cilësisë kryhet nga Drejtuesi i DAB-së
31	Komentet/vlerësimet e procesit të rishikimit të brendshëm të cilësisë janë pjesë e dosjes së auditimit.				+	Po
	<b>Totali i pikëve të seksionit "Rishikimi i brendshëm i cilësisë së veprimtarisë audituese"</b>				12	
<b>Dokumentimi i punës audituese</b>						
32	Dosjet e përhershme/të përkohshme plotësojnë kërkesat e MAB dhe arkivohen sipas legjislacionit në fuqi.				+	Cdo dosje auditimi është arkivuar në zbatim të legjislacionit në fuqi
	<b>Totali i pikëve të seksionit "Dokumentimi i punës audituese"</b>				4	
<b>PIKËT GJITHSEJ</b>			6		124	<b>Totali 130</b>

Udhëzues për kryerjen e vetëvlerësimit duke përdorur pikëzimin:

- 1 - NjAB nuk e përmbush kriterin
- 2 - NjAB përmbush kriterin pjesërisht
- 3 - NjAB e përmbush kriterin por ka vend për përmirësime
- 4 - NjAB përmbush kriterin